



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I ARTEVE

Rr. Agim Ramadani; P.N. 10000 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel.: +381 38 220 294; web-mail: www.arte.uni-pr.edu

| | |
|-----------------------------------|---|
| Curriculum- Syllabus | |
| Viti Akademik 2025/2026 | |
| Të dhënat bazike të lendes | |
| Njësia Akadematike: | Fakulteti i Arteve/ Departamenti i Arteve te Bukura/ Programi i Arteve Vizuele/ Profili: Skulpturë |
| Titulli i lëndës: | Instalacion |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Vitit II |
| Numri i orëve: | 3 (H) + 0 (U) |
| ECTS: | 4 |
| Ora / lokacioni: | E hënë / 11:30 – 13:45h |
| Mësimdhënësi: | MR. Art. Adem Rusinovci- Prof |
| Kontakti: | E- mail: adem.rusinovci@uni-pr.edu Mob: + 383 (0) 44 151 113 |
| Përshkrimi i lëndës | |
| Qëllimet e lëndës | <p>Kjo lëndë i ofron studentëve një kuptim të thellë të artit të instalacionit, si një medium ndërdisiplinor dhe interaktiv. Duke eksploruar aspekte si hapësira, materiali, narrativa, performanca dhe ndërveprimi, studentët do të analizojnë dhe krijojnë instalacione që sfidojnë kufijtë tradicionalë të artit. Kursi përfshin studimin e praktikave bashkëkohore, përfshirë artistë ndërkombëtarë dhe shqiptarë, duke i inkurajuar studentët të zhvillojnë një gjuhë të personalizuar artistike.</p> <ul style="list-style-type: none">- Të eksplorojë historinë dhe zhvillimin e artit të instalacionit.- Të ndihmojë studentët të zhvillojnë një kuptim të elementeve ndijorë dhe konceptuale të instalacionit.- Të analizojë ndikimin e hapësirës, materialeve dhe narrativës në krijimin artistik.- Të inkurajojë përdorimin e metodave ndërdisiplinore dhe teknologjive të reja në art.- Të aftësojë studentët për krijimin dhe dokumentimin profesional të veprave të tyre. |

Rezultatet e të nxënësit**Njohuritë**

- Kuptimi i historisë dhe teorive kryesore të artit të instalacionit.
- Njohja e praktikave bashkëkohore të artistëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë.
- Të kuptuarit e ndikimit të elementeve si drita, tingulli dhe materialet në perceptimin ndijor.
- Kuptojnë historinë e artit të instalacionit dhe zhvillimin e tij nga skulptura tradicionale deri tek instalacionet digjitale.
- Kuptojnë ndërveprimin midis publikut dhe instalacionit si element kyç i veprës artistike.
- Shpjegojnë ndikimin e teknologjisë në artet hapësinore dhe mediat ndërdisiplinore.
- Njohin artistë kryesorë ndërkombëtarë dhe shqiptarë që kanë kontribuar në zhvillimin e instalacionit.
- Kuptojnë rolin e artit të instalacionit në ndërlidhjen e historisë, narrativës dhe aktivizmit.
- Identifikojnë qasjet ritualistike dhe eksperimentale në artin e instalacionit.

Shkathtësitë

- Krijimi i instalacioneve që komunikojnë ide dhe narrativa komplekse.
- Eksperimentimi me materiale dhe teknologji të ndryshme.
- Përdorimi i teknikave për dokumentimin dhe prezantimin e instalacioneve.
- Zhvillojnë ide për instalacione që ndërthurin elemente vizuale, materiale dhe ndijore.
- Prototipizojnë instalacione për hapësira specifike duke përdorur teknologji dhe materiale të ndryshme.
- Dokumentojnë procesin dhe rezultatet e krijimit për prezantim dhe arkivim.
- Integrojnë elemente virtuale dhe fizike në instalacione hibride.
- Analizojnë dhe reflektojnë mbi ndikimin e materialeve, hapësirës dhe publikut në artin e instalacionit.
- Vlerësojnë kontributin e artistëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë në artin bashkëkohor.

| | |
|--|---|
| | <p>Kompetencat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i një praktike personale artistike bazuar në të menduarit kritik dhe kreativ. • Aftësia për të punuar në mënyrë ndërdisiplinore dhe bashkëpunuese. • Përshtatja e veprave në kontekste kulturore dhe publike. • Krijojnë dhe realizojnë instalacione të bazuara në hulumtime dhe koncepte të mirëpërcaktuara. • Angazhojnë publikun përmes instalacioneve që trajtojnë tema bashkëkohore dhe ndjeshmëri ndijore. • Bashkëpunojnë në projekte grupore për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse artistike. • Ndërveprojnë me audiencën dhe komunitetin përmes veprave të bazuara në hapësirë. • Komunikojnë idetë artistike përmes prezantimeve dhe ekspozitave. • Reflektojnë mbi procesin e tyre krijues dhe zhvillimin personal në art. • Demonstrjnë aftësi për të përshtatur artin ndaj sfidave dhe konteksteve të ndryshme teknologjike dhe sociale. |
|--|---|



Kontributi në detyrën e studentit (që duhet të përputhet me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditët/javët | Total |
|---|-----|-------------|-------|
| Ligjerata | 3 | 30 | 90 |
| Ushtrime teorike/ laboratorike | 0 | 0 | 0 |
| Punë praktike | 1 | 2 | 2 |
| Konsulta me mësuesin/konsultime | 1 | 2 | 2 |
| Ushtrime në terren | 0 | 0 | 0 |
| Kolokium, punim semestral | 1 | 2 | 2 |
| Detyra shtëpie | 1 | 2 | 2 |
| Koha e studentëve për studim (në bibliotekë ose në shtëpi) | 0 | 0 | 0 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 1 | 1 |
| Projekte, prezantime, etj. | 1 | 1 | 1 |

| | | | |
|-------------------------------------|---|--|------------|
| Total | | | 100 |
| | | | |
| Metodologjia e Mësimdhënies: | <p>Semestri dimëror:</p> <p>Zhvillimi i kuptimit teorik të instalacionit dhe eksperimentimi fillestar me materiale, hapësira dhe narrativa.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata Teorike: Diskutimi i historisë së artit të instalacionit, artistëve dhe praktikave kyçe. - Diskutime mbi evoluimin e hapësirës dhe perceptimit në artin bashkëkohor. - Workshop-e Eksperimentale: Eksperimentim me materiale tradicionale dhe jo-tradicionale (p.sh., dritë, plastikë, metal). - Testimi i efekteve ndijore të dritës, tingullit dhe ngjyrës në hapësira të ndryshme. - Projekte të Vogla: Krijimi i instalacioneve të vogla që ndërthurin narrativën dhe hapësirën. - Pjesëmarrja aktive në prezantime dhe diskutime të punimeve në grup. - Hulumtim Individual: Identifikimi i një teme personale për zhvillim gjatë semestrit veror. - Hulumtim mbi artistët dhe teknikat që lidhen me idetë e zgjedhura. <p>Semestri veror:</p> <p>Zbatimi praktik i njohurive dhe aftësive në krijimin e projekteve të plota dhe përgatitja për prezantimin publik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i Projekteve Kryesore: Projektimi dhe ndërtimi i instalacioneve më komplekse. - Eksperimentimi me ndërthurjen e teknologjisë, performancës dhe hapësirave dixhitale. - Krijimi i instalacioneve që përfshijnë ndërveprimin e publikut dhe hapësirave publike. - Kritika dhe Feedback: Sesione kritike ku studentët marrin komente mbi punimet e tyre. - Reflektimi mbi procesin e krijimit dhe zhvillimit artistik. - Dokumentimi i Instalacioneve: Përdorimi i teknikave për dokumentimin profesional (fotografi, video dhe shkrime). - Diskutimi mbi ruajtjen e veprave për arkiva dhe ekspozita të ardhshme. - Ekspozita Përfundimtare: Përgatitja e një ekspozite grupore me instalacionet e përfunduara. - Diskutimi publik mbi veprat gjatë hapjes së ekspozitës. - Reflektimi përfundimtar mbi të nxënit dhe zhvillimin gjatë kursit. | | |
| | | | |

| | | | |
|--|---|----------------|--|
| METODAT E VLERËSIMIT: | Sistemi i Vlerësimit për Instalacion | | |
| | Vlerësimi është i ndarë në katër faza që përfshijnë vijueshmërinë e studentëve, angazhimin në aktivitete të ndryshme, realizimin e projekteve dhe performancën përfundimtare. Secila fazë përbëhet nga afërsisht 8 njësi mësimore, dhe përqindjet e pikëve rriten progresivisht me zhvillimin e studentëve dhe kompleksitetin e detyrave. | | |
| FAZA 1: DISKUTIMI I KONCEPTIT TË INSTALACIONIT SI MEDIUM ARTISTIK. (20%) | | | |
| Komponenti | Përqindja | Pikët | Sqarim |
| Pjesëmarrja aktive dhe debatet mbi temat teorike | 5% | 5 pikë | Angazhimi në ligjërata, prezencë dhe përfshirje aktive në diskutime. |
| Debate dhe kritikë grupore | 5% | 5 pikë | Kontributi në diskutime dhe ndarja e mendimeve për punën personale dhe atë të bashkëstudentëve. |
| Projekti i parë; Krijim Koncepti mbi një vepër artistike në përputhshmëri me ligjeratat e spjeguar | 5% | 5 pikë | Skicimi, shkrimi i tekstit të artistit dhe përcaktimi i mediumit të veprës. |
| Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë | 5% | 5 pikë | |
| Totali për Fazën 1 | 20% | 20 pikë | |
| FAZA 2: ZHVILLIMI I AFTËSIVE DHE HULUMTIMEVE ARTISTIKE, NARRATIVA NË INSTALACION (20%) | | | |
| Komponenti | Përqindja | Pikët | Sqarim |
| Detyrat e shtëpisë dhe hulumtimet | 5% | 5 pikë | Zhvillimi i Aftësive dhe Hulumtimeve Artistike, Ndërveprimi dhe Publiku. Arti i instalacionit - Si ndërtohet një histori përmes objekteve dhe hapësirës. |
| Projekti i dytë: Ese mbi Instalacionet interaktive | 10% | 10 pikë | Përfshirja në katër fazat e projektit (prekja e disa epokave artistike, dhe krijimi personal), si dhe prezantimi i eseve shoqëruese. |
| Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë | 5% | 5 pikë | |
| Totali për Fazën 2 | 20% | 20 pikë | |
| FAZA 3: NDËRVEPRIMI NË ART DHE DOKUMENTIMI I INSTALACIONEVE (25%) | | | |
| | Përqindja | | Sqarim |

| | | | |
|---|------------|----------------|---|
| Pjesëmarrja në vizita dhe debate në klasë | 5% | 5 pikë | Përfshirja në aktivitetet e Galerisë së Arteve dhe aktiviteteteve të tjera kulturore. |
| Projekti i tretë: Punim Seminarik dhe Prezantim | 10% | 10 pikë | Realizimi i projektit në varësi të temës së caktuar mbi epokat e spjeguar në sillabus. |
| Kritika dhe reflektimi grupor | 5% | 5 pikë | Përfshirja në analizën dhe përmirësimin e projekteve personale dhe të bashkëstudentëve. |
| Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë | 5% | 5 pikë | |
| Totali për Fazën 3 | 25% | 25 pikë | |

FAZA 4: PËRGATITJA DHE PROJEKTI/VEPRA PËRFUNDIMTARE (35%)

| | Përqindja | | Sqarim |
|--|------------------|-----------------|---|
| Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë gjatë fazës përfundimtare | 5% | 5 pikë | Kontributi në diskutime mbi temat e zhvilluara në klasë |
| Projekti përfundimtar: Realizimi I konceptit mbi një vepër artistike në përputhshmëri me ligjeratat e spjeguar | 20% | 20 pikë | Realizimi i projektit finale me fokus në stilin personal dhe qasjen origjinale, si dhe prezantimi e ekspozimit të saj. |
| Ekspozita | 5% | 5 pikë | Organizimi dhe prezantimi i punimeve përfundimtare në ekspozitë, si dhe mbrojtja e temës përmes analizës kritike të veprës personale. |
| Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë | 5% | 5 pikë | |
| Totali për Fazën 4 | 35% | 35 pikë | |
| Totali i Përgjithshëm | 100% | 100 pikë | |

SHPËRNDARJA E PIKËVE PËR NOTAT

| | |
|----------------------------|----------|
| Pikët < 50 | Nota = 5 |
| Pikët >= 50 dhe Pikët < 60 | Nota = 6 |
| Pikët >= 60 dhe Pikët < 70 | Nota = 7 |
| Pikët >= 70 dhe Pikët < 80 | Nota = 8 |

| | |
|----------------------------|-----------|
| Pikët >= 80 dhe Pikët < 90 | Nota = 9 |
| Pikët >= 90 | Nota = 10 |

Literatura

Literatura Bazë:

- *"Vitamin 3-D: New Perspectives in Sculpture and Installation", Phaidon Press.*
- *Claire Bishop, "Installation Art: A Critical History".*
- *Nicolas de Oliveira, Nicola Oxley dhe Michael Petry, "Installation Art in the New Millennium: The Empire of the Senses".*
- *Rosalind Krauss, "Passages in Modern Sculpture".*
- *Bishop, Claire. Installation Art: A Critical History. Tate Publishing, 2005.*
- *Kaprow, Allan. Essays on the Blurring of Art and Life. University of California Press, 2003.*
- *Kwon, Miwon. One Place After Another: Site-Specific Art and Locational Identity. MIT Press, 2004.*
- *Bourriaud, Nicolas. Relational Aesthetics. Les Presses du Réel, 2002.*
- *Salcedo, Doris. Shifting Sites: The Art of Doris Salcedo. University of Chicago Press, 2016.*
- *Eliasson, Olafur. The Weather Project. Tate Modern, 2003.*
- *Bishop, Claire. Artificial Hells: Participatory Art and the Politics of Spectatorship. Verso Books, 2012.*
- *Turrell, James. Seeing Yourself See: Light and Space Art. Phaidon Press, 2013.*
- *Kusama, Yayoi. Infinity Net: The Autobiography of Yayoi Kusama. Tate Publishing, 2012.*
- *Boltanski, Christian. Christian Boltanski: Lessons of Darkness. Flammarion, 2004.*

| | |
|---------------------------------------|--|
| Literatura Shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> - Marina Abramović, "Walk Through Walls: A Memoir". - Olafur Eliasson, "Studio Olafur Eliasson: An Encyclopedia". - Doris Salcedo, "The Materiality of Mourning". - Christian Boltanski, "The Possible Lives of Christian Boltanski". - Artikuj akademikë dhe katalogë ekspozitash nga artistë shqiptarë si Adrian Paci, Petrit Halilaj dhe Anri Sala. - Lozano-Hemmer, Rafael. <i>Relational Architecture</i>. MIT Press, 2016. - Hatoum, Mona. <i>Terra Infirma</i>. Tate Publishing, 2016. - Zeneli, Driant. <i>Beneath a Surface There Is Just Another Surface</i>. Revolver Publishing, 2019. - TeamLab. <i>Art in the Age of Immersion</i>. Phaidon, 2020. - O'Doherty, Brian. <i>Inside the White Cube: The Ideology of the Gallery Space</i>. University of California Press, 1986. - Graham, Dan. <i>Two-Way Mirror Power: Selected Writings by Dan Graham on His Art</i>. MIT Press, 1999. - De Oliveira, Nicolas, et al. <i>Installation Art in the New Millennium: The Empire of the Senses</i>. Thames & Hudson, 2004. - Groenick, Uta, et al. <i>Art Now: Installation</i>. Taschen, 2008. - Groys, Boris. <i>Art Power</i>. MIT Press, 2008. - Bourgeois, Louise. <i>Destruction of the Father / Reconstruction of the Father: Writings and Interviews, 1923–1997</i>. MIT Press, 1998. <p style="text-align: center;"><i>Shtesa mbi Artistët Shqiptarë dhe Rajonalë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Paci, Adrian. <i>Gestures: A Retrospective</i>. Fondazione Galleria Civica, 2010. - Halilaj, Petrit. <i>Shkrepëtima</i>. Fondazione Merz, 2019. - Gjergji, Helidon. <i>Illuminations and Other Works</i>. Revolver Publishing, 2017. - Zeneli, Driant. <i>Maybe the Cosmos is Not So Extraordinary</i>. Archive Books, 2021. - Ivanović, Ana. <i>Art and Memory in the Balkans: Installation Works</i>. Routledge, 2015. |
| Plani i Mësimimit të Dizenjuar | |
| Java e parë: | Diskutimi i konceptit të instalacionit si medium artistik. |
| Java e dytë: | Evolucioni i artit të instalacionit nga modernizmi në artin bashkëkohor. |
| Java e tretë: | Instalacion dhe Hapësira - Studimi i përdorimit të hapësirës si element kryesor në instalacion. |
| Java e katërt: | Artistë: Allan Kaprow (happenings dhe ndërthurja e artit me jetën), Joseph Beuys (skulptura sociale) dhe Eva Hesse (hapësira dhe materiali), James Turrell (drita dhe perceptimi) dhe Dan Flavin (fluorescenca). |
| Java e pestë: | INTRO; Hapësira dhe Perceptimi Ndijor |
| Java e gjashtë: | Ndikimi i dritës, ngjyrës dhe tingullit në perceptimin e artit. |
| Java e shtatë: | Materialet tradicionale dhe jo-tradicionale në art, dhe eksplorimi i materialeve industriale dhe të ricikluara në art. |

| | |
|---------------------------------|---|
| Java e tetë: | Artistë: Olafur Eliasson (elementet natyrore dhe perceptimi), Doris Salcedo (historitë personale dhe materialet), Richard Serra (materialet e rënda) dhe Isa Genzken (struktura dhe forma). |
| Java e nëntë: | INTRO; Narrativa në Instalacion |
| Java e dhjetë: | Si ndërtohet një histori përmes objekteve dhe hapësirës. |
| Java e njëmbëdhjetë: | Publiku si Element - Roli i publikut në artin e instalacionit. |
| Java e dymbëdhjetë: | Instalacion në Hapësira Publike - Krijimi i instalacioneve në ambiente të hapura dhe dialogu me komunitetin. |
| Java e trembëdhjetë: | Artistë: Mona Hatoum (narrativa personale dhe politike), Yayoi Kusama (hapësirat e pasqyrave) dhe Rafael Lozano-Hemmer (teknologjia dhe interaktiviteti), Ai Weiwei (aktivizmi dhe hapësira publike). |
| Java e katërbëdhjetë: | INTRO; Artistë Shqiptarë në Instalacion dhe Artistë Shqiptarë Bashkëkohorë |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Eksplorimi i veprave të Adrian Pacit dhe Petrit Halilajt. Diskutimi i veprave të Helidon Gjergjit dhe Anri Salës. |
| Java e gjashtëmbëdhjetë: | Ndërlidhja e historisë personale me hapësirën. Eksplorimi i temave shqiptare në artin e instalacionit. |
| Java e shtatëmbëdhjetë: | Ndërthurja e performancës dhe hapësirës fizike - Performanca në Instalacion. |
| Java e tetëmbëdhjetë: | Hapësirat Dixhitale dhe Virtuale - Ndikimi i teknologjisë në artin e instalacionit. |
| Java e nëntëmbëdhjetë: | Politika dhe Instalacioni - Përdorimi i instalacionit për të trajtuar çështje shoqërore dhe politike. |
| Java e njëzet: | Artistë: Marina Abramović (kufijtë e trupit dhe hapësirës), TeamLab (dixhitalizimi i hapësirës) dhe Driant Zeneli (eksplorimi i utopisë), Theaster Gates (komuniteti dhe artet). |
| Java e njëzet e një: | Ndërveprimi në Art dhe Dokumentimi i Instalacioneve |
| Java e njëzet e dy: | Ndërtimi i instalacioneve që inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të publikut. |
| Java e njëzet e tre: | Kujtesa dhe Historia në Art - Si shprehen kujtesa dhe historia kolektive në instalacione. |
| Java e njëzet e katër: | Të Menduarit Ndërdisciplinor - Ndërthurja e artit me shkencën dhe teknologjinë. |
| Java e njëzet e pesë: | Si të ruani dhe të dokumentoni një instalacion për ekspozita të ardhshme - Praktika dhe teknika për dokumentimin profesional. |
| Java e njëzet e gjashtë: | Artistë: Ernesto Neto (hapësirat ndijore), Christian Boltanski (kujtesa dhe humbja), Tomás Saraceno (ekologjia dhe teknologjia). |
| Java e njëzet e shtatë: | INTRO; Prototipimi dhe Prezantimi |

| | |
|--|--|
| Java e njëzet e tetë: | Eksperimentimi në hapësirë - Krijimi i prototipeve për instalacione në mjedise specifike. Kritika dhe Feedback - Diskutimi dhe kritika mbi instalacionet e studentëve. |
| Java e njëzet e nëntë: | Instalacionet në Kontekste Ndërkombëtare - Si ndikon konteksti kulturor në instalacion? |
| Java e tridhjetë: | Prezantimi i ideve për ekspozim publik - Përgatitja për ekspozita ose instalacione në hapësira reale dhe dokumentimi i instalacionit - Si të ruani dhe prezantoni një instalacion për arkiva ose ekspozita virtuale. |
| Politikat akademike dhe rregullat e sjelljes: | |
| <p>Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe parimet e integritetit akademik, politikat dhe rregullat e mëposhtme janë përcaktuar për të siguruar një mjedis të drejtë, respektues dhe të orientuar drejt rezultateve të suksesshme akademike.</p> <p>Respektimi i Orarit dhe Pjesëmarrja në Mësim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët duhet të respektojnë në mënyrë të rreptë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve. Mosprezenca e paarsyetuar mund të ndikojë negativisht në vlerësimin përfundimtar. • Studenti duhet të njoftojë paraprakisht mësimdhënësin për çdo mungesë të arsyeshme, duke paraqitur dokumentacion përkatës. • Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe diskutime është një pjesë integrale e procesit të nxënies. <p>Pajisjet dhe Përgatitja e Studentëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët duhet të jenë të përgatitur për çdo sesion mësimor, duke sjellë të gjitha mjetet e nevojshme për punë (p.sh., bllokun e skicave, mjete për pikturim, dhe materiale të tjera sipas temave mësimore). • Mosplotësimi i këtyre kërkesave mund të ndikojë në vlerësimin e tyre në bazë të angazhimit dhe përgjegjësisë. <p>Sjellja Akademike dhe Etika Profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çdo student duhet të tregojë respekt të plotë ndaj mësimdhënësve, kolegëve dhe stafit administrativ. Çdo sjellje e pahijshme, përfshirë fyerjet ose pengesat e qëllimshme gjatë orës mësimore, do të ndëshkohet sipas rregulloreve disiplinore të Universitetit. • Diskutimet dhe debatet në klasë duhet të jenë konstruktive dhe të bazuara në mirëkuptim dhe respekt reciprok. • Studentët janë të ndaluar të përvetësojnë punën e tjetrit dhe të paraqesin atë si të tyre. Plagjiatura dhe mashtrimet akademike do të trajtohen sipas masave disiplinore të Statutit. | |

Ruajtja e Rregullit dhe Qetësisë

- Studentët duhet të sigurojnë që ambienti mësimor të jetë i pastër, i qetë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Çdo ndotje ose dëmtim i pasurisë së universitetit do të sjellë masa ndëshkimore, përfshirë edhe kompensimin për dëmet.
- Telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknologjike duhet të shkyçen gjatë orëve mësimore, përveç rasteve kur janë të autorizuar nga mësimdhënësi për qëllime mësimore.

Integriteti në Vlerësim dhe Prezantim

- Çdo student duhet të prezantojë punimet e tij/saj të përfunduara me përpikëri dhe në kohë, sipas kërkesave të programit.
- Gjatë provimeve dhe prezantimeve, studentët duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna dhe të shmangin çdo formë mashtrimi.
- Çdo formë plagjiature, kopjimi ose ndihme të paautorizuar gjatë provimeve do të ndëshkohet sipas Statutit.

Obligimet e Studentëve ndaj Procesit të Mësimdhënies

- Studentët janë të obliguar të respektojnë autoritetin akademik të mësimdhënësve dhe të ndjekin udhëzimet e tyre për realizimin e projekteve dhe detyrave mësimore.
- Është e detyrueshme që studentët të mbajnë dokumentacion të vazhdueshëm mbi procesin e tyre krijues (ditar pune), i cili do të përdoret për reflektim dhe vlerësim gjatë dhe në fund të semestrit.

Dispozita për Mosrespektim të Rregullave

- Çdo mosrespektim i rregullave të mësipërme do të rezultojë në masa ndëshkimore të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Prishtinës. Këto masa përfshijnë:
 - Paralajmërime verbale ose me shkrim.
 - Ulje të pikëve në vlerësim.
 - Përfshirje nga provimi ose kursi, varësisht nga serioziteti i shkeljes.
 - Vendimet për masat disiplinore do të merren në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të universitetit.

Këto rregulla janë në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe janë krijuar për të siguruar një mjedis të drejtë, të sigurt dhe të frytshëm për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.